



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.1816/5 prot.

Tiranë, më 19.12.2023

VENDIM

Nr. 70, datë 19.12.2023

PËR KONTROLLUESIN “GOGI KIDS EDUCATION SHPK”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara, në ngarkim të Kontrolluesit “GoGi Kids Education SHPK” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 181, datë 13.11.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, me fokus të veçantë publikimin/informimin/njoftimin/marketingun dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS M01801018A, dhe ushtron aktivitetin si institucion arsimor privat në bazë të programeve të çerdhes, kopshtit dhe parashkollorit, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë, “fëmijë”, “nxënës”, “punonjës”, “prindër/kujdestar ligjor”. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi grumbullon në arkivin fizik dhe të sekretarisë mësimore dokumentacionin për fëmijët, nxënësit, prindër/kujdestar ligjor dhe stafin akademik. Konstatohet se, në Zyrën e Sekretarisë, ruhen kopje të jetëshkrimit, kartës së identitetit, certifikata dhe diploma të punonjësve aktualë dhe atyre të larguar.

Rezulton se Kontrolluesi disponon rregullore të brendshme dhe rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate konkrete, lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale, për dokumentacionin që administrojnë, në funksion të veprimtarisë që ushtron.

Të dhënat e mbledhura nga Kontrolluesi ruhen pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me germen “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit, si dhe Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e gremës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

3. Konstatohet se, Kontrolluesi aplikon “Formular Regjistrimi”, për të marrë të dhënat e fëmijës, të dhënat e prindërve/kujdestarëve ligjorë, informacione lidhur me shëndetin e fëmijës, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si dhe “kontratë shërbimi” tip për prindrit/kujdestarët ligjorë. Nëpërmjet modelit tip të formularit të regjistrimit, është parashikuar rubrika e dhënies së pëlqimit për prindin/kujdestarin ligjor, lidhur me publikimin e fotografive të fëmijëve në rrjetet sociale që Kontrolluesi disponon, të tilla si “facebook” dhe “instagram”. Megjithatë, rezulton se në këtë formular, informimi nuk është i plotë, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit.

Informimi nga Kontrolluesi, nuk është shterues në lidhje me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e

mbajtjes së të dhënave, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje) etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi, sipas përcaktimeve të nenit 18 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, që kryen Kontrolluesi.

4. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, si dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për “Njoftim”, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Kontrolluesi, pas marrjes dijeni të urdhrat të hetimit administrativ, ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Megjithatë, konstatohet se “Njoftimi” ka mangësi në deklaram, sa i përket rubrikave të formularit, si vijon:

- i. Deklarimi në rubrikën nr. 3: Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen, ku nuk është parashikuar kategoria “*prindër/kujdestar ligjor*”;
- ii. Deklarimi në rubrikën nr. 6: Qëllimi i përpunimit “*statistikor*”.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për “Njoftim”, mbi përpunimin e të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

5. Nga verifikimet e kryera në vend, rezulton se Kontrolluesi disponon “*Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj konstatohet se, rregullorja nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, në të cilin të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh të të dhënave), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., pasi konsiderohet një detyrim mjaft i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

6. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa sa i përket trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura, sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit. Për më tepër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, marrja e masave për zhvillimin dhe dokumentimin e trajnimeve të përshtatura për punonjësit, që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, është një nga masat e sigurisë së të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit në rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit. Përfaqësuesja e Kontrolluesit u paraqit në seancë dëgjimore, gjatë së cilës parashitroi verbalisht qëndrimin e saj, lidhur me konstatimet e grupit të hetimit.

Kontrolluesi, gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, parashitroi pretendimet, si më poshtë:

- *Shkeljet e konstatuara janë kryer si rrjedhojë e mosnjohjes së legjislacionit shqiptar të mbrojtjes së të dhënave personale. Nga momenti i njohjes me dispozitat e sanksionuara në Ligj, do të ndërmerren veprimet përkatëse për përmbushjen e detyrimeve ligjore.*

Lidhur më këtë pretendim, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk qëndron, pasi ligji *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar, është në fuqi që nga viti 2008, si dhe prezumohet i ditur nga momenti i botimit të tij në Fletoren Zyrtare. Për rrjedhojë, Kontrolluesi nuk mund të justifikojë mosplotësimin e detyrimeve ligjore për shkakun e mosnjohjes së ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

- *Për sa i përket dokumentacionit të stafit, këto dosje mbahen për një afat kohor 5 vjeçar, në përputhje me legjislacionin tatimor.*

Lidhur më këtë pretendim, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk qëndron, pasi nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion gjatë hetimit administrativ, Kontrolluesi nuk ka mundur të dokumentojë përcaktimin e afatit të ruajtjes së të dhënave personale në aktet e veta të brendshme rregullatore, në përputhje me qëllimin e grumbullimit. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a”, “b”, “d” dhe “dh”, të pikës 1, të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) *kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- b) *kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*
- d) *kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- dh) *kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;*

Në bazë të pikës 2, të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe kriterëve për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjes së masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 18, 21, 22, 27, 29, 30, 31, 39 pika 1, germat “a”, “b”, “d” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40 000 (dyzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;

- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit;
- 3- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40 000 (dyzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit;
- 4- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të Ligjit;
- 5- Kontrolluesi, të ketë në vëmendje proceset e përpunimit të të dhënave personale, për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
- 6- Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave për të gjitha proceset përpunuese, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
- 7- Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të “Njoftojë” Zyrën e Komisionerit, për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës;
- 8- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
- 9- Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në nenin 27 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti, brenda afateve, si vijon:

- i. vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 5, 6 dhe 9 më sipër;
- ii. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 7 më sipër;
- iii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e parashikuar në pikën 8 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

- 10- Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;

11- Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit;

12- Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 19.12.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi